

Duke bërë vizitën me Video Thirrje

The Royal Melbourne Hospital - Telehealth video call

Kur është e përshtatshme, mund ta bëni konsultimin online me Video Thirrje

Video thirrja është e përshtatshme aq sa një thirrje telefonike, duke ja shtuar përparësinë e komunikimit ballë për ballë.

Të kursen kohën dhe paratë, dhe ta sjellë kujdesjen më afër shtëpisë



Ku duhet të shkojë për vizitën time?

Për të marrë pjesë në vizitën tënde, shkoni në:

www.thermh.org.au/telehealth

Në vend që të udhëtoni për vizitën tuaj, futeni në pjesën e pritjes online (në kompjuter).

Shërbimi shëndetësor njoftohet për arrijten tuaj, dhe klinicisti juaj shëndetësor do bashkohet me ju online kur të jetë gati.

Nuk është nevoja të krijoni një llogari në internet

Nuk ruhet asnjë informacion që fusni në kompjuter



Çfarë më duhet për të bërë thirrje me Video Thirrje?



Një lidhje të mirë të internetit

Nëse keni mundësi të shikoni një video online (p.sh. YouTube) mund të bëni thirrje me video



Një dhomë private, të ndriçuar mirë ku nuk të bezdis jush, gjatë konsultimit



Një prej këtyre:

- Shfletuesi i Uebit Google Chrome (rekomandohet) ose Firefox në një kompjuter desktop ose laptop (Windows ose MacOS), ose me Tablet Android ose smartphone
- Shfletuesi Web Safari në një Apple desktop ose laptop (MacOS), ose iPad ose iPhone



Ueb-kamera, altoparantët dhe mikrofon (që janë të ndërtuar mbrenda laptopëve ose telefonave celular)

Shikoni faqen tjetër për informacione të tjera se si të bëni një video thirrje



A është e sigurt ?

Video thirrjet janë të sigurta. Privatësia e juaj është e mbrojtur. Keni dhomën tuaj private për video të cilën vetëm klinicistët e autorizuar shëndetësorë mund ta përdorin



Sa kushton një video thirrje?

Thirrja me video është falas (përveç koston së përdorimit të internetit). Megjithatë, kostoja e zakonshme – nëse ekziston – të një konsultimi mjekësor do të aplikohet.



Sa të dhëna interneti do të përdor?

Ju nuk përdorni ndonjë të dhënë ndërsa jeni duke pritur që klinicisti të bashkohet me ju.

Një konsultim me video përdor më pak se gjysmën e të dhënave që do të përdorje gjatë shikimit të një videoje në YouTube me Përcaktim të Lartë (HD)*.

Përdorimi i të dhënave është më i paktë në lidhjet e internetit me shpejtësi më të ulët, ose nëse përdorni një Tablet kompjuteri ose smartphone më pak të fuqishëm. Këta faktorë mund të pakësojnë cilësinë e përgjithshme të thirrjes.

Përdorimi i të dhënave rritet kur ka më shumë se dy pjesëmarrës gjatë thirrjes.



Përdoruesit e smartphone dhe tabletëve:

Nëse keni mundësi, lidheni me një rrjetë Wi-Fi në shtëpi ose punë për të shmangur përdorimin e të dhënave tuaja të celularit.

* Është afërsisht 230 MB në një telefon celular dhe 450 MB në një PC (komjuter) ose për një thirrje 20-minutsh që është e ngjashme me Skype® se Facetime®.

Bëhuni gati për video thirrje



Sigurohuni që përdorni një nga shfjetuesit e mëposhtëm të internetit



Google Chrome Versioni 80+
(Windows, Android, MacOS)



Apple Safari Versioni 12+
(MacOS, iOS)



Firefox Versioni 75+
(Windows, Android)




Microsoft Edge Versioni 80+
(Windows, MacOS)
Microsoft Edge Versioni 44+
(Android)



Shikoni në: www.thermh.org.au/telehealth

1

Shkoni në pikën e hyrjes në faqen e internetit të shërbimit dhe klikoni në **ikonën e fillimit të video thirrjes**




2

Fusni emrin dhe numrin e telefonit kur ju kërkohet


3

Futuni në "Zona e Pritjes" të klinikës të



4

Klinikisti vjen dhe fillon konsultimi



! Çfarë të bëj nëse diçka nuk ecën si duhet?

- Shkoni në: <https://vcc.healthdirect.org.au/troubleshooting>

Për informacione të tjera

To cancel, reschedule, or change your appointment, call 03 93427393.
For an interpreter, please call 03 93427393.

For video-call support, please call 03 93428670.
telehealth@mh.org.au